



Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, takohet me drejtorët e shoqërive të sigurimit

Problematika e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik (MTPL), si në drejtim të tarifave të zbatuara, ashtu edhe të pagesës së dëmshpërblimeve, ishin në qendër të diskutimeve.

Vijon në faqen 2

Mbi fillimin e projektit për hartimin e strategjisë së zhvillimit të tregut të letrave me vlerë me mbështetjen e FSVC, USAID
Vijon në faqen 8

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizon trajnimin “Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri”

Vijon në faqen 9

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për vitin 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2012 u rritën me 7.38% krahasuar me vitin 2011.

Vijon në faqen 3

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2012

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë vitit 2012, u dominua nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).

Vijon në faqen 5

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në takime pune me Shoqatën e Siguruesve të Turqisë dhe institucione të tjera rregullatore të sigurimeve, në kuadër të projektit për liberalizmin e sigurimit të detyrueshëm motorik

Vijon në faqen 10

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me asistencën e Bankës Botërore, fillon projektin për harmonizimin e legjislacionit të pensioneve private vullnetare me direktivat e BE-së dhe parimet e OECD-së

Vijon në faqen 10

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Agjencionin për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, MAPAS, Maqedoni

Vijon në faqen 7

Zhvillohet faza e dytë e trajnimit “Mbikëqyrja me fokus riskun” pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Vijon në faqen 7

TË REJA NGA RAJONI

Bullgari

Vijon në faqen 11

Kosovë

Vijon në faqen 12

Kroaci

Vijon në faqen 12

Sllloveni

Vijon në faqen 13

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, takohet me drejtorët e shoqërive të sigurimit

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më 15 janar 2013 një takim me drejtorët e shoqërive të sigurimit për të diskutuar mbi produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik (MTPL), si në drejtim të tarifave të zbatuara, ashtu edhe në drejtim të pagesës së dëmshpërblimeve. Nisur nga gjendja aktuale kur tarifatat e zbatuara vlerësohen se janë në nivele relativisht të ulëta, nëse krahasohen me vlerësimin e riskut për produktin, Znj. Shehi vuri theksin që AMF, duke luajtur rolin e vet si autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i tregut, do të vijojë të marrë të gjitha masat e nevojshme për ndryshimin e gjendjes. Vëmendje të veçantë në këtë aspekt do të ketë vlerësimi me shumë kujdes i provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimit për këtë produkt.

Aktualisht, në bazë të ligjeve përkatëse në fuqi, të ndryshuara, tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik është i liberalizuar dhe përcaktimi i primit të shitjes është detyrë e çdo shoqërie sigurimi. Në këto kushte, përpjekjet e shoqërive për të zbatuar tarifa në nivele të tilla që orientohen kryesisht drejt ruajtjes së pozicionit të tyre në treg, janë pasqyruar në çmime më të ulëta sesa primi i riskut. Një qasje e tillë, theksoi kryetarja e AMF-së, mbështetet në objektiva afatshkurtër në administrimin e këtij produkti dhe nëse nuk orientohet nga objektivat afatgjatë mund të sjellë efekte negative në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive.

Në takim u theksua edhe njëherë nevoja për kategorizimin e drejtë dhe mbi këtë bazë edhe tarifimin e saktë të produkteve, me qëllim shmangien e abuzimeve në lidhje me ndryshimin e kategorive. Znj. Shehi propozoi marrjen e një sere masash në drejtim të përmirësimit të situatës, duke filluar me përditësimin e informacionit në sistemin online, deri në marrjen e masave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për rastet e shkeljeve apo të moszbatimit të dispozitave ligjore. Një tjetër çështje që u trajtua në takim ishte ajo e miratimit të fondit të kompensimit për vitin 2013, si dhe detyrimi që kanë shoqëritë për të bërë pagesat e të gjitha dëmeve tashmë të përcaktuara me vendime të formës së prerë të gjykatës.

Kryetarja e AMF-së kërkoi më shumë profesionalizëm nga shoqëritë, si në përcaktimin e tarifave për produktet e sigurimit të detyrueshëm, ashtu edhe në respektimin e të drejtave të konsumatorit në drejtim të përcaktimit të saktë të masës së dëmshpërblimit dhe dhënien e tij brenda afateve kohore të përcaktuara nga ligji.

Znj. Shehi propozoi marrjen e një sere masash në drejtim të përmirësimit të situatës, duke filluar me përditësimin e informacionit në sistemin online, deri në marrjen e masave sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për rastet e shkeljeve apo të moszbatimit të dispozitave ligjore.


VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për vitin 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2012 arritën shifrën 8,951,050 mijë lekë, përkundrejt 8,335,903 mijë lekë të realizuara në vitin 2011 ose 7.38% më shumë se në vitin e kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 48.86% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 51.14% të tregut. Përsa i takon tregut, në veçanti, kemi një rënie në masën 17.38% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje prej 10.90% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 89.85% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.83% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.32% nga veprimtaria e risigurimit.

Në vitin 2012 u nënshkruan rreth 1,057,821 kontrata sigurimi, ose 19.00% më pak se në vitin 2011.

Struktura e tregut të sigurimeve, për vitin 2012




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për vitin 2012 arritën shifrën 8,951,050 mijë lekë, përkundrejt 8,335,903 mijë lekë të realizuara në vitin 2011 ose 7.38% më shumë se në vitin e kaluar.

Volumi i primit të shkruar bruto, për vitin 2011, 2012.

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)		
	Viti	2011	2012
A) Sigurim i Jetës		1,065,536	880,304
B) Sigurim i Jo-Jetës		7,251,965	8,042,473
<i>Nga këto:</i>			
a) Sigurimi Detyrueshëm		3,727,116	4,577,470
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)		3,524,849	3,465,003
C) Risigurimi		18,403	28,274
TOTAL		8,335,903	8,951,050

Volumi i primit të shkruar bruto, për vitin 2012 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në vitin 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 4,577,470 mijë lekë të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për vitin 2012, arritën 3,369,701 mijë lekë, ose 52.81% më shumë se në vitin 2011.

Në vitin 2012, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 688,173 mijë lekë, ose rreth 37.56% më pak se në vitin 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto karton jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë vitit 2012 arritën në 519,596 mijë lekë, apo 23.80 % më shumë se në vitin 2011.

Sigurimet vullnetare

Për vitin 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 4,373,580 mijë lekë, ose 5.10 % më pak se të ardhurat e vitit 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 3,465,003 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 49.30 % të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 17.92 %, dhe nga sigurimi kasko me 15.65 %, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në vitin 2012, arritën në 621,061 mijë lekë, ose 29.05 % më pak se në vitin të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 62.30 % të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në vitin 2012 arritën në 880,304 mijë lekë, ose 17.38 % më pak se në vitin 2011.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: SIGAL UNIQA Group Austria, SIGMA Vienna Insurance Group, INSIG, ATLANTIK, INTERALBANIAN, ALBSIG, INTERSIG Vienna Insurance Group EUROSIG dhe ANSIG. SIGAL UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 30.33 % të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për vitin 2012 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për vitin 2012 (Jeta)



Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve për vitin 2012 kapi vlerën 2,823,440 mijë lekë, ose 27.68 % më shumë se në vitin 2011.


Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria, INSIG dhe SICRED. SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 51.16 % të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve për vitin 2012 kapi vlerën 2,823,440 mijë lekë, ose 27.68 % më shumë se në vitin 2011. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,704,962 mijë lekë, apo 60.39 % të totalit.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2012

Letra me Vlerë të Qeverisë, 2012



- A - Blerje në tregun primar
- B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosje e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë vitit 2012, u dominua në masën 64.31% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 35.69% ishin instrumente

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2012, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 44.04% dhe 27.71% kundrejt volumit të përgjithshëm.

afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97.47% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2012, flasin për një dominim të transaksioneve “*Blerje në tregun primar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me 44.04% dhe 27.71% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 98.75% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B** “*Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar*” gjatë vitit 2012 ka pasur një rritje prej 131.57 milionë lekë ose në masën 1.90%, krahasuar me vitin 2011. Kjo është shoqëruar me një ulje në masën 9.57% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit **C** “*Blerje nga individët para afatit të maturimit*” gjatë vitit 2012 ka pasur një rritje prej 2,555.45 milionë lekë ose 82.23%, krahasuar me vitin 2011. Kjo është shoqëruar me një rritje në masën 4.49% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me vitin 2011, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 2,687 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Trans.	Vlera nominale (në mln lekë)	Ndryshimi (në %)			
		Viti	2011	2012	'12/'11-1
Letra me Vlerë të Qeverisë					
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar		6,934.80	7,066.37	1.90
	<i>Individë</i>		5,781.30	5,872.98	1.59
	<i>Persona juridike</i>		1,153.49	1,193.39	3.46
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit		3,107.58	5,663.03	82.23
	<i>Individë</i>		1,686.75	5,020.98	197.67
	<i>Persona juridike</i>		1,420.83	642.05	(54.81)

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Agjencionin për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, MAPAS, Maqedoni

Në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale me organizmat homologë në rajon, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, nënshkroi në 28 dhjetor 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Agjencionin për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, MAPAS, Maqedoni.

Marrëveshja përfshin shkëmbimin e përvojave të dy institucioneve në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të pensioneve private vullnetare dhe kuadrit ligjor që rregullon këto fusha. Bashkëpunimi do të shtrihet edhe në aspektin teknik, si në shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, dokumentacionit dhe organizmin e trajnimeve të përbashkëta.

Duke e vlerësuar mjaft të rëndësishëm nënshkrimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, theksoi efektin e madh që sjellin marrëveshje të tilla bashkëpunimi në rajon në forcimin e tregut të pensioneve private, si një treg i ri, por që ka dëshmuar një ritëm të shpejtë zhvillimi.

Nënshkrimi i marrëveshjeve të tilla bëhet edhe më i rëndësishëm në kushtet kur bashkëpunimi rajonal intensifikohet për shkak të nevojës së zbatimit të direktivave të BE-së. Kjo marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në rritjen e integritetit, qëndrueshmërisë dhe efektshmërisë së mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve të të dy vendeve tona.

Që prej krijimit të institucioneve mbikëqyrëse të Tregut të Sigurimeve, Letrave me Vlerë dhe Pensioneve Vullnetare, të cilat formuan më pas Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, janë nënshkruar shumë marrëveshje me institucione homologe në rajon e më gjerë të tilla si me autoritetet homologe të Austrisë, Bullgarisë, Greqisë, Italisë, Kosovës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Polonisë, Rumanisë, Sllovenisë, Turqisë, etj. AMF është gjithashtu anëtare e tri organizmave ndërkombëtare: Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, prej vitit 2001, Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë, IOSCO prej vitit 1998 dhe Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS prej vitit 2006.

Zhvillohet faza e dytë e trajnimit “Mbikëqyrja me fokus riskun” pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me mbështetjen e USAID-it, nëpërmjet Programit të Zhvillimit të Sektorit Financiar në Shqipëri (FSVC), organizuan fazën e dytë të trajnimit, “Mbikëqyrja me Fokus Riskun” gjatë periudhës 12-16 janar pranë AMF-së. Pjesëmarrës në trajnim ishin specialistë të mbikëqyrjes të AMF-së.

Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, theksoi efektin e madh që sjellin marrëveshje të tilla bashkëpunimi në rajon në forcimin e tregut të pensioneve private, si një treg i ri, por që ka dëshmuar një ritëm të shpejtë zhvillimi.

Trajner i këtij programi, konsulent i certifikuar në sigurime, ishte William D. Cundiff me eksperience mbi 30 vjeçare në tregun e sigurimeve, si dhe trajner në kurse të ngjashme që prej 2005 në mjaft institute në Londër.



Kryetarja e AMF-së, Znj. E.Shehi, trajneri i programit, Z. William D. Cundiff dhe pjesëmarrësit në trajnimin "Mbikëqyrja me fokus Riskun"

Gjatë trajnimit të zhvilluar në fazën e parë, shtator 2012, pjesëmarrësit morën njohuritë teorike për efektivitetin e mbikëqyrjes me fokus riskun, mënyrën si ajo influencon shoqëritë e sigurimit dhe ndikimin pozitiv që kjo mënyrë mbikëqyrjeje ka në mbrojtjen e interesave të të siguarave pranë këtyre shoqërive. Mbledhja e informacionit dhe analizat paraprake, inspektimi, matrica e riskut dhe vlerësimi i saj, ishin disa nga tematikat kryesore të trajtuara.

Në fazën e dytë u bë një gërshetim i njohurive teorike me rastet konkrete të studimit. Pjesëmarrësit punuan në grupe pune me raste studimore duke zbatuar konceptet teorike mbi raste të mundshme situatash për mbikëqyrje në tregun e sigurimeve. Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën me certifikata.

Mbi fillimin e projektit për hartimin e strategjisë së zhvillimit të tregut të letrave me vlerë me mbështetjen e FSVC, USAID

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me mbështetjen e Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC, gjatë periudhës 4-8 shkurt filloi projektin për hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri.

Ekspertët Igor Gvozdanovic nga Kroacia dhe William Jannace nga SHBA, bashkëpunuan me specialistë dhe drejtues të AMF-së në përcaktimin e fokusit kryesor ku do të përqendrohet zhvillimi i sektorit të letrave me vlerë në vend. Eksperti Igor Gvozdanovic është Drejtor Ekzekutiv i fondit të investimit "Platinum Invest" në Kroaci dhe sjell përvojën e sektorit privat të tregut të kapitaleve për një vend i cili shumë shpejt do të jetë anëtar i Bashkimit Evropian. Eksperti William Jannace, jurist i specializuar për tregun e letrave me vlerë dhe vullnetar i FSVC ka punuar edhe më parë në projekte të tilla asistence në Jordani edhe në Rusi. Grupi i punës për hartimin e kësaj strategjie zhvilloi takime në Kabinetin e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Bankën e Shqipërisë, Bursën e Tiranës, Dhomën e Tregtisë, si edhe me subjektet private që operojnë në tregun e letrave me vlerë.

Misioni i ekspertëve të huaj për tregun e letrave me vlerë do të synojë në:

- Vlerësimin e kuadrit rregullues legjislativ;
- Përcaktimin e nivelit aktual të zhvillimit dhe faktorëve kryesorë që e influencojnë atë;

Mbledhja e informacionit dhe analizat paraprake, inspektimi, matrica e riskut dhe vlerësimi i saj, ishin disa nga tematikat kryesore të trajtuara.

- Dhënien e rekomandimeve për AMF lidhur me barrierat e mundshme si edhe mundësitë për zhvillim më tej të këtij tregu;
- Hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në vend.

Projekti dhe veçanërisht ndërtimi i strategjisë për zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri është i rëndësishëm për momentin në të cilin ai po zhvillohet. Aktualisht tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione) është segmenti më aktiv i letrave me vlerë në vend.

Një sinjal pozitiv zhvillimi ishte licencimi dhe fillimi nga veprimtaria, më 1 shkurt 2012, i fondit të parë të investimeve në vend, “Raiffeisen Prestigj”. Po kështu në shtator të vitit 2012 u licencua edhe Fondi i Investimit “Raiffeisen Invest Euro”.

Gjatë vitit 2012, Bursa e Tiranës nënshkroi një marrëveshje për bashkëpunim rajonal, në krijimin e një platforme rajonale elektronike të tregtimit. Projekti parashikon integrimin e tetë bursave të rajonit në këtë platformë të përbashkët dhe ky zhvillim shihet si hap nxitës për tregun e brendshëm të kapitalit.

Të gjithë këta faktorë, e bëjnë ndërtimin e strategjisë për tregun e letrave me vlerë një nevojë për t’ju përgjigjur dhe paraprirë zhvillimeve ekonomike.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizon trajnimin “Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, AMF, me mbështetjen e Bankës Botërore organizuan trajnimin, “Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri”. Trajnimi u zhvillua në periudhën 21-22 shkurt pranë AMF-së. Pjesëmarrës në trajnim ishin specialistë të fushës së aktuaristikës, nga departamentet e marrjes në sigurim dhe të dëmeve të shoqërive të sigurimit, si dhe specialistë e drejtues të mbikëqyrjes në AMF.

Programi i trajnimit përmbante temat kryesore që lidhen me tarifimin me bazë risku dhe provigjionimin në kontekstin e tregut shqiptar të sigurimit të detyrueshëm motorik. Pjesëmarrësit morën njohuritë teorike për metodologjinë e llogaritjes së primeve, mënyrat e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit për të llogaritur primet e bazuara mbi riskun, analizat për llogaritjen e klasifikimin kur konsiderojmë faktorë të ndryshëm të riskut, etj. Gjatë trajnimit u bë konkretizimi i njohurive teorike, me shembuj konkrete të studimit.

AMF, e mbështetur nga Banka Botërore, ka filluar që prej vitit 2011 projektin mbi “Liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL” me synimin për të lehtësuar kalimin drejt mbikëqyrjes me bazë risku. Projekti është tashmë në fazën përfundimtare dhe janë hartuar dokumentet strategjike për zhvillimin e tarifimit efektiv me bazë risku, si për shoqëritë e sigurimeve, ashtu edhe për AMF-në si autoritet rregullator.

Trajner i këtij programi ishte Sergio de Santis, aktuar dhe ekspert i Bankës Botërore me përvojë në tregun italian të sigurimeve.

— — — — —
Një ndër çështjet që
tërhoqi më shumë
diskutime ishte
mbikëqyrja
e korporatave.
— — — — —

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në takime pune me Shoqatën e Siguruesve të Turqisë dhe institucione të tjera rregullatore të sigurimeve, në kuadër të projektit për liberalizmin e sigurimit të detyrueshëm motorik

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, së bashku me një grup pune zhvilluan në datat 25-26 shkurt takime me drejtues të Shoqatës së Siguruesve të Turqisë, Byronë e Kartonit Jeshil dhe Qendrën për Informacionin në Sigurime. Programi u realizua me mbështetjen e Bankës Botërore, në kuadër të projektit për liberalizimin e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Tematikat kryesore të diskutimeve lidheshin me shkëmbimin e përvojave për ndërtimin e bazës së të dhënave për menaxhimin e sigurimit të detyrueshëm motorik, monitorimin e sistemit të tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, rolin e aktuarëve në llogaritjen e rezervës së dëmeve, si dhe të tarifave të sigurimi të detyrueshëm motorik. Në takimet e zhvilluara me kryetarin e shoqatës së byrosë dhe përfaqësues të lartë nga tregu u diskutua edhe shkëmbimi i përvojave në drejtim të forcimit institucional të autoriteteve rregullatore, pozicioneve dhe përgjegjësi specifike që ka çdo institucion në mbarëvajtjen e tregut të sigurimeve, rolin e Fondit të Garancisë, Byrosë së Kartonit Jeshil, zyra të arbitrazhit, etj.

Shoqata e siguruesve në Turqi ka aktivitetet të gjatë që nis prej fillimit të shekullit të kaluar dhe konsolidohet më tej pas themelimit të Republikës Turke. Më pas ndryshime legjislative dhe kuadri rregullues ju përshtat zhvillimeve të tregut duke sjellë edhe hartimin e Statutit të Shoqatës së Siguruesve dhe Risiguruesve të Turqisë i cili hyri në fuqi në 1976. Në vitin 1987 kjo shoqatë u shndërrua në një institucion publik dhe ndër objektivat e saj kryesore ishte zhvillimi i mëtejshëm i profesionin të siguruesve. Të gjitha shoqëritë e sigurimit në Turqi janë të detyruara të jenë anëtare të Shoqatës së Siguruesve dhe Risiguruesve të Turqisë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u përfaqësua në këto takime nga Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare, Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike, Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit TI, Kërkimit dhe Statistikës, Z. Donal Papalilo, Drejtor i Drejtorisë së TI dhe Znj. Juliana Dengeri, aktuale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me asistencën e Bankës Botërore fillon projektin për harmonizimin e legjislacionit të pensioneve private vullnetare me direktivat e BE-së dhe parimet e OECD-së

Në kuadër të projektit për harmonizimin e legjislacionit të pensioneve private vullnetare me direktivat e Bashkimit Evropian dhe parimet e OECD-së, eksperti

i njohur Z. John Ashcroft, zhvilloi një sërë takimesh pune me drejtues e specialistë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe me aktorë të tregut.

Projekti, i cili do të zhvillohet në periudhën janar-mars 2013, është financuar nga Banka Botërore, nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar. Ai synon të krijojë një harmonizim sa më të plotë të kuadrit rregullues, legjislativ dhe mbikëqyrës për sistemin e pensioneve private vullnetare. Tregu i pensioneve vullnetare në Shqipëri është ende në zhvillim dhe aktualisht veprojnë tre fonde pensioni vullnetar, të administruara nga tri shoqëri administruese.

Legjislacioni aktual, që rregullon tregun e pensioneve private vullnetare ka hyrë në fuqi në vitin 2009 dhe ka pasur një përputhshmëri të lartë me direktivat e BE-së por dinamika e ndryshimit në legjislacionin evropian në katër vitet e fundit në këtë fushë, ka sjellë nevojën e një tjetër rishikimi të hollësishëm të legjislacionit.

Nevoja për harmonizimin e plotë të legjislacionit rregullues të tregut të pensioneve private vullnetare me direktivat e BE-së, vjen edhe si rezultat i angazhimeve që AMF ka marrë në funksion të kërkesave nga Komisioni Evropian, si pjesë e procesit të anëtarësimit të ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është unifikimi i praktikave dhe proceseve në kolonën e tretë, duke i hapur rrugën dhe ndërtimit të infrastrukturës së mbikëqyrjes, për të mirëpritur një reformë të mundshme të pensioneve, si prezantimi i kolonës së dytë.

Rezultatet e projektit pritet të konkretizohen në mars 2013, ku më tej ato do të detajohen në propozime konkrete për ndryshime ligjore.

TË REJA NGA RAJONI

Bullgari

<http://www.xprimm.com/>

Tregu i sigurimeve në Bullgari, sipas Shoqatës Bullgare të Brokerëve në Sigurime, pësoi rënie edhe gjatë 2012, rënie kjo që ndodh për të katërtin vit radhazi. Kjo tendencë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2013, ndoshta për faktin se tregu i sigurimeve motorike është në një gjendje stanjacioni dhe mundësitë e rritjes janë shteruar. Arsyet kryesore të përfshirjes në krizën financiare qenë rënia drastike e shitjes së makinave dhe rënia e vlerës së automjeteve të siguruara. Kompanitë e sigurimeve fillimisht u përpoqën të rrisnin çmimin e TPL-së, por më pas vendosën që nuk ka vend për një rritje të konsiderueshme të këtij çmimi.

Sipas Shoqatës Bullgare (të cilës i referohet agjencia e lajmeve xprimm) situata nuk do përmirësohet as për sigurimin Kasko. Kështu, normat e sigurimit Kasko po bien për shkak të "luftës" midis siguruesve për të marrë si klientë korporatat e mëdha.

Nevoja për harmonizimin e plotë të legjislacionit rregullues të tregut të pensioneve private vullnetare me direktivat e BE-së, vjen edhe si rezultat i angazhimeve që AMF ka marrë në funksion të kërkesave nga Komisioni Evropian, si pjesë e procesit të anëtarësimit të ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

Arsyet kryesore të përfshirjes në krizën financiare qenë rënia drastike e shitjes së makinave dhe rënia e vlerës së automjeteve të siguruara.

Në një deklaratë për median, dega e SEB, grup bankar në Estoni theksoi se të gjitha kompanitë e sigurimeve në Estoni do të duhet t'i përmbahen parimit unisex kur përfundojnë kontratat e sigurimit duke filluar nga 21 dhjetor 2012.

Kosovë

<http://www.xprimm.com/>

Primet e shkruara bruto në tregun e kosovar të sigurimeve, në fund të vitit 2012 arritën në 81.5 milion euro, me një rritje prej 4.4% krahasuar me vitin e mëparshëm. Gjatë 2012, numri i policave të shitura ishte mbi 757 mijë, duke shënuar një rritje prej 25%.

Primet e shkruara bruto në tregun kosovar të sigurimeve, në fund të vitit 2012 arritën vlerën 81.5 milion euro me një rritje prej 4.4% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Aktivitetet e shoqërive të sigurimit vazhduan të përqendrohen kryesisht në policat e përgjegjësive ndaj palëve të treta, të cilat gjenerojnë rreth 54% të të gjitha primeve, ndërsa pjesa e mbetur e primeve të shkruara bruto u siguria nga sigurimi vullnetar.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2012, primi i shkruar bruto nga shitja e policave të TPL-së arriti vlerën 44.2 milion euro, ose 3.4% më pak se viti i mëparshëm. Pjesa tjetër e primit të shkruar bruto përbëhet nga sigurimi vullnetar (22.6 milion euro ose 28% e primeve totale) dhe sigurimi kufitar (14.7 milion euro, ose 52.6% më shumë në krahasim me vitin e kaluar).

Rritja e primeve të shkruara bruto u shoqërua dhe nga një rritje e lartë e dëmeve të paguara, të cilat në vitin 2012 arriti vlerën 30.6 milion euro me një rritje vjetore prej 14% krahasuar me vitin 2011. Raporti ndërmjet primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara në vitin 2012 ishte 37.5%, ndërsa në vitin 2011 ishte 34.3%, gjë që tregon se numri i dëmeve të paguara është rritur më shpejt se të vëllimit të marrjes në sigurim.

Kroaci

<http://www.xprimm.com/>

Aktiviteti i siguruesve kroatë vazhdon të mbetet i influencuar nga treguesit makroekonomikë të tillë si rritja ekonomike, papunësia apo të ardhurat reale. Gjatë vitit të kaluar, 12 nga 27 shoqëri të sigurimeve shënuan rënie në totalin e tyre të primeve të shkruara bruto. Në vitin 2012, shoqëritë kroate të sigurimeve kapën një total të primeve të shkruara bruto afërsisht 1.19 miliard euro apo 1.17%, njoftoi Byroja Kroate e Sigurimeve (HUO).

Në të njëjtën kohë, totali i dëmeve të paguara arriti në afro 610 milion euro, duke përfaqësuar një rritje prej 1.1% krahasura me 2011.

Sloveni

<http://www.xprimm.com/>

Zyra lokale e KPMG-së (të cilës i referohet agjencia e lajmeve xprimm) njofton se që prej datës 25 dhjetor 2012, Sllovenia ka prezantuar një taksë të re për shërbimet financiare. Legjislacioni për shërbimet financiare (Financial Services Tax Act), përcakton detyrimin për të paguar një taksë mbi shërbimet financiare, (të cilat në përgjithësi janë të përjashtuara nga TVSH), si dhe shërbimet e ofruara nga brokerat dhe agjentët e sigurimit.

Taksa e re, prej 6.5%, do të vendoset në kryerjen e shërbimeve financiare. Shërbimet financiare konsiderohen të jenë të dhëna kur komisioni për shërbimet përkatëse është paguar.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, R. Eltari, E. Beqir-Aga, Dh. Hazbiu, E. Kokona

